



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS  
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2020:043436

Datë: 24.12.2024

Numri i dokumentit: 06646996

K.DH.SH.II.nr.1596/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Dren Rogova, kryetar, Faton Bajrami dhe Krenar Berisha, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “MAB” SH.P.K., me NUI: 810549157, dhe seli në rr. “Shefki Kuleta” p.nr., Komuna e Fushë Kosovës, kundër të paditurit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, me seli në Prishtinë, me bazë juridike: anulim i aktit administrativ – përkatësisht anulim i Vendimit me Nr. Prot. 1185 të datës 02.03.2020, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.394/22 të datës 03.06.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 24.12.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e të paditurit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.394/22 i datës 03.06.2024, PRISHET dhe lënda i KTHEHET Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Administrative, në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

1. Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Administrative, (tani e tutje: “Gjykata e shkallës së parë”), me Aktgjykimin KA.nr.394/22 të datës 03.06.2024, (tani e tutje: “aktgjykimi i ankimuar”), me pikën I të dispozitivit ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit “MAB” SH.P.K., me seli në Prishtinë, (tani e tutje: “paditësi”), ashtu që: ka anuluar tërësisht Vendimin me Nr. Prot. 1185 të datës 02.03.2020, (tani e tutje: “akti i kontestuar administrativ”), të Bordit të të paditurit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, me seli në Prishtinë, (tani e tutje: “i padituri” ose “KPMM”); dhe çështjen juridike administrative në shkallë të dytë të procedurës administrative e ka vendosur ashtu që e ka aprovuar ankesën administrative të paditësit dhe e ka anuluar tërësisht Aktvendimin me Nr. Prot. 4916 të datës 10.12.2019 të të paditurit, si akt administrativ të organit administrativ të

shkallës së parë në procedurë administrative. Ndërsa me pikën II të dispozitivit ka theksuar se aktgjykimi e zëvendëson aktin administrativ të anuluar me pikën I të dispozitivit.

2. Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka ushtruar ankesë i padituri për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, (tani e tutje: “Gjykata e shkallës së dytë”), ta anulojë aktgjykimin e ankimuar dhe çështjen juridike administrative t’ a kthejë tek Gjykata e shkallës së parë për rishqyrtim dhe rivendosje.
3. Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar paditësi.
4. Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, si gjykatë e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi ligjshmërinë e çështjes juridike administrative në kuptim të nenit 12 të Ligjit Nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale, dhe nenit 194 të LPK-së të ndërlidhur me nenin 63 të LKA-së, në drejtim të thënieve në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të tjera të lëndës vlerësoi se:
  - Ankesa është e bazuar.
5. Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësi pranë Gjykatës së shkallës së parë ka parashtruar padi kundër të paditurit për inicimin e konfliktit administrativ, me kërkesë për anulimin e aktit të kontestuar administrativ. Në lidhje me këtë çështje juridike administrative paditësi ka pretenduar se i padituri i ka shqiptuar atij gjobë administrative në lartësi prej 5000 €, sepse kinse paditësi ka ushtruar aktivitet pa leje për aktivitete të veçanta nga baza e betonit për lokacionin në fshatin Shupkocë të Komunës së Mitrovicës. Paditësi ka shtuar se betonierën e ka lëshuar me qira për qiramarrësin z. A.B, i cili sipas Kontratës mbi Qiranë e Betonierës të datës 01.01.2019, (tani e tutje: “Kontrata mbi Qiranë”), ka qenë i obliguar të ushtrojë aktivitetin sipas dispozitave ligjore. Sipas paditësit, ai nuk ka pasur legjitimitet për këtë rast, pasi veprimet i ka ndërmarrë një subjekt tjetër e jo ai. Paditësi, ndër të tjera, ka shtuar se neni 79, para. 4 i Ligjit Nr.03/L-163 për Minierat dhe Minerale, (tani e tutje: “LMM”), parasheh që personit që ka zhvilluar aktivitet pa licencë mund t’i shqiptohet gjoba administrative, por jo personit tjetër.
6. Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Administrative, si gjykatë e shkallës së parë, pasi ka administruar provat e propozuara, mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor dhe pasi ka vlerësuar çështjen juridike administrative, në Aktgjykimin e saj KA.nr.394/22 të datës 03.06.2024, ka ardhur në përfundim se kërkesëpadija e paditësit lidhur me paligjshmërinë e aktit të kontestuar administrativ të të paditurit është e bazuar.
7. Gjykata e shkallës së parë pasi ka bërë vlerësimin e provave të administruara, pretendimeve të palëve dhe shkresave të tjera të lëndës në këtë konflikt administrativ, ndër të tjera, ka ardhur në konstatimet si në vijim:
  - 7.1. Me datë 27.06.2019, Inspektorati i Minierave i të paditurit ndaj paditësit ka lëshuar urdhëresën për ndërprerjen e aktivitetit të jashtëligjshëm minerar dhe ka vendosur shiritat e policisë në

lokacionin në fshatin Shupkoc të Komunës së Mitrovicës, pasi ka konstatuar se paditësi ka kryer aktivitet të jashtëligjshëm mineralar;

- 7.2. Me datë 29.10.2019, Inspektorati i Minierave i të paditurit përsëri e ka inspektuar lokacionin në fshatin Shupkoc të Komunës së Mitrovicës dhe përsëri ka konstatuar se paditësi ka kryer aktivitet ilegal duke prodhuar beton pa u pajisur me leje për aktivitet të veçantë dhe njëherazi e ka dënuar paditësin me gjobë administrative në lartësi prej 5000 €. Gjatë këtij inspektimi, Inspektorati i Minierave i të paditurit e ka hasur z. A.B nga Komuna e Mitrovicës, i cili ka sqaruar se mjetet e punës i'a ka dhënë vëllai i tij për të punuar. Ai gjithashtu kishte pranuar se ai i ka larguar shiritat e policisë në vendin e ngjarjes dhe ka kryer aktivitet mineralar;
- 7.3. Me datë 10.12.2019, i padituri, në cilësinë e organit administrativ të shkallës së parë në procedurë administrative, ka nxjerrë Aktvendimin Nr. Prot. 4916, me të cilin paditësit i është shqiptuar gjobë administrative në lartësi prej 5000 €, për shkak të zhvillimit të aktivitetit të jashtëligjshëm mineralar në kuptim të nenit 79, para. 4 të LMM-së. Ndaj këtij aktvendimi paditësi ka ushtruar ankesë administrative në shkallë të dytë të procedurës administrative, të cilën ankesë Bordi i të paditurit, në cilësinë e organit administrativ të shkallës së dytë të procedurës administrative, e ka refuzuar si të pabazuar dhe e ka vërtetuar vendimin e shkallës së parë në procedurë administrative, përmes Vendimit Nr. Prot. 1185 të datës 02.03.2020.
- 7.4. Mes palëve ndërgjyqëse assesi nuk ka qenë kontestues fakti i mungesës së licencës përkatëse për paditësin ose fakti që është kryer aktiviteti i jashtëligjshëm mineralar, por kontestuese ka qenë se kush e ka kryer këtë aktivitet të kundërligjshëm: paditësi apo dikush tjetër;
- 7.5. Në lidhje me këtë, Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se paditësi me datë 01.01.2019, pra para se të ishin kryer inspektimet e cekura më lart, ka lidhur Kontratën mbi Qiranë në formë të shkruar me z. A.B, përmes të cilës kontratë ky i fundit si qiramarrës e ka marrë me qira betonjerkën me adresë në fshatin Shupkoc në Komunën e Mitrovicës deri me datë 31.12.2019;
- 7.6. Duke qenë se në njërën anë paditësi ka paraqitur Kontratën mbi Qiranë për periudhën e inspektimit, vetë z. A.B. si qiramarrës gjatë inspektimit të datës 29.10.2019 kishte deklaruar se ai i ka hequr shiritat e policisë dhe ka kryer aktivitetin mineralar, ndërsa mjetet i ka marrë nga vëllai i tij, kurse në anën tjetër nuk ka pasur asnjë provë nga e cila qartazi do të vërtetohej se pikërisht paditësi përmes punëtorëve e ka kryer aktivitetin mineralar të jashtëligjshëm, atëherë Gjykata e shkallës së parë ka ardhur në përfundimin se paditësi nuk ka kryer aktivitet të jashtëligjshëm mineralar, por atë aktivitet e ka kryer z. A.B.
- 7.7. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se i padituri nuk e ka konstatuar drejtë gjendjen faktike. Në këtë drejtim, Gjykata e shkallës së parë nuk e ka konsideruar të provuar faktin se pikërisht paditësi e ka kryer aktivitetin e kundërligjshëm mineralar. Gjykata e shkallës së parë ka rikujtuar se në shkresat e lëndës administrative nuk është gjendur asnjë provë, në bazë të të cilave është bërë lidhja kauzale në mes të paditësit dhe aktivitetit mineralar. Gjithashtu, Gjykata e shkallës së parë ka shtuar se i padituri përmes përgjigjes në padi nuk ka paraqitur prova të tjera nga të cilat do të mund vërtetohej se pikërisht paditësi e ka kryer aktivitetin e kundërligjshëm mineralar. Në

anën tjetër, paditësi ka paraqitur Kontratën mbi Qiranë, si dhe qiramarrësi gjatë inspektimit të datës 29.10.2019 u kishte sqaruar inspektorëve të të paditurit se ai i ka hequr shiritat policorë dhe e ka zhvilluar aktivitetin e kundërligjshëm minerar;

- 7.8. Për Gjykatën e shkallës së parë është konstatuar si i pabazuar pretendimi i të paditurit se Kontrata mbi Qiranë ka qenë e pavlefshme, meqë nuk është lidhur te noteri dhe nuk e ka aprovuar paraprakisht ai, pra paditësi në cilësinë e organit administrativ kompetent. Në vazhden e kësaj, Gjykata e shkallës së parë ka shtuar se LMD nuk përmban dispozita në pjesën e veçantë të tij, sipas të cilave do të përcaktohej forma e aktit noterial për kontratën e qirasë. Në këtë drejtim sipas Gjykatës së shkallës së parë, as LMM e as ligji përkatës për noterinë nuk parashohin formën e aktit noterial për kontratën e qirasë. Për këto arsye, Gjykata e shkallës së parë ka ardhur në përfundim se Kontrata mbi Qiranë e lidhur ndërmjet paditësit dhe z. A.B është juridikisht e vlefshme, rrjedhimisht është e mjaftueshme për të vërtetuar se paditësi nuk ka qenë në shfrytëzim të lokacionit të inspektuar në fshatin Shupkocv të Komunës së Mitrovicës, por z. A.B.
- 7.9. Si përfundim, Gjykata e shkallës së parë e ka vlerësuar si të pabazuar pretendimin e të paditurit se asnjë lloj kontrate nuk mund të jetë e vlefshme pa pasur leje për aktivitete të veçanta dhe pa marrë aprovim paraprak nga ai (KPM). Në rend të parë, Gjykata e shkallës së parë ka sqaruar se LMM, së bashku me ndryshime, askund nuk e parasheh pëlqimin e të paditurit për vlefshmërinë e çfarëdo kontrate. Gjykata e shkallës së parë gjithashtu ka qenë e vetëdijshme se kontrata e qirasë, pavarësisht se a jepet nga subjekti i licencuar nga KPM ose nga ndonjë subjekt i palicencuar, nuk paraqet autorizim për qiramarrësin që të ushtrojë ndonjë aktivitet minerar pa lejen e KPM-së, pasi për ushtrimin e aktivitetit minerar është e nevojshme licenca përkatëse, e cila ka vlefshmëri personale, kohore dhe territoriale vetëm si është cekur në atë. Prandaj, Gjykata e shkallës së parë nuk e ka trajtuar Kontratën mbi Qiranë si bazë që i lejon paditësit që të kryejë aktivitet minerar, por vetëm si provë në bazë të së cilës, në kombinim me rrethanat të tjera të këtij rasti, vërtetohet se paditësi nuk ka qenë në shfrytëzim të lokacionit në të cilin është kryer aktiviteti i kundërligjshëm minerar.
8. Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerësoi se qëndrimi dhe përfundimi juridik i Gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë pasi që aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore të LPK-së, për të cilat shkelje Gjykata ankimore kujdeset në kuptim të nenit 194 të LPK-së të ndërlidhur me nenin 63 të LKA-së. Si rrjedhojë e këtyre shkeljeve procedurale, Gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, rrethanë kjo që pashmangshmërisht ka rezultuar edhe me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale.
9. Gjykata e shkallës së dytë, sa i përket pretendimeve ankimore të të paditurit në lidhje me shkeljet e dispozitave procedurale, gjeti se:
- 9.1. Qëndron si i bazuar pretendimi ankimor i të paditurit në lidhje me atë se Gjykata e shkallës së parë në këtë konflikt administrativ ishte dashur të zbatonte rregullën e barrës së provës, në kuptim të nenit 322, para. 1 të LPK-së, për pranueshmërinë e Kontratës mbi Qiranë si provë të pranueshme. Për më tepër ku e njëjta kontratë ka luajtur rolin e provës primare në konstatimin e

gjendjes faktike për këtë çështje juridike administrative – që njëkohësisht ka paraqitur bazë faktike solide për përjashtimin e paditësit nga përgjegjësia në fjalë për ushtrimin e veprimtarisë së kundërligjshme minerare. Në lidhje me vërtetimin e ekzistencës së Kontratës mbi Qiranë dhe legjitimitetit të saj si provë në konflikt administrativ, Gjykata ankimore vlerësoi se një shqyrtim i tillë i bërë nga Gjykata e shkallës së parë nuk do të mund të vetë mjaftohej me këtë kontratë si provë materiale. Në këtë drejtim, gjykata në konflikt administrativ do të duhej të shqyrtonte të gjitha rrethanat që në momentin e marrjes së vendimit nga organi administrativ, përfshirë këtu edhe faktet e nxjerra nga organi administrativ në momentin e inspektimit. Sepse, është e evidente se subjektet afariste që operojnë në treg, lehtësisht mund ta bartin përgjegjësinë përmes një prove që mund të përpilohet pa ndonjë pasojë juridike.

- 9.2. Gjykata ankimore gjeti se barra e provës në rastin konkret në kuptim të nenit 322, para. 2 të LPK-së i ka takuar paditësit. Për këto arsye, paditësi duke qenë i ngarkuar me barrën e provës ai do të duhej të parashtronte prova të besueshme se në momentin e inspektimit ka qenë subjekti qiramarrës nga kontrata subjekt i cili e ka kryer kundërvajtjen administrative.
- 9.2.1. Neni 322, para. 1 i LPK-së thekson: *“Në qoftë se gjykata në bazë të provave të marra (neni 8 i këtij ligji) nuk mund të konstatojë me siguri ndonjë fakt, për ekzistimin e faktit do të përfundojë duke i aplikuar rregullat mbi barrën e provës”*.
- 9.2.2. Neni 322, para. 2 i LPK-së thekson: *“Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër”*.
- 9.3. Si vijimësi e kësaj, është vlerësuar si i bazuar pretendimi ankimor i të paditurit se arsyetimi i aktgjykimit të ankimuar në kuptim të nenit 160, para. 4 të LPK-së paraqet një arsyetim të mangët sa i përket vlerësimit të pranueshmërisë si provë dhe legjitimitetit të Kontratës mbi Qiranë në këtë konflikt administrativ. Sa i përket kësaj, Gjykata e shkallës së dytë shqyrtoi hollësisht aktgjykimin e ankimuar, përkatësisht përmbajtjen e arsyetimit të tij, dhe gjeti se Gjykata e shkallës së parë edhe pse ka dhënë arsyetimet përkatëse për ekzistimin e Kontratës mbi Qiranë në fjalë nga aspekti formalo-juridik, e njëjta në aktgjykimin e ankimuar nuk ka dhënë arsyetimet përkatëse, përtej aspektit formalo-juridik, se përse një kontratë e tillë e përjashton paditësin nga përgjegjësia. Në veçanti nëse e paditura pa mëdyshje ka vërtetuar se ka qenë paditësi subjekti që ka kryer kundërvajtjen.
10. Kolegji i kësaj gjykate, në lidhje me konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, vlerësoi se:
- 10.1. Duke u nisur nga pretendimi ankimor i të paditurit, Kolegji i kësaj gjykate shqyrtoi Urdhëresën për Ndërprerjen e Aktivitetit të Jashtëligjshëm Minerar me No: 000093 dhe Ref. 004/KPMM, nga i cili shqyrtim vërtetoi se z. R.T.ka bërë pranimin e urdhëresës në fjalë në emër dhe në llogari të paditësit, përkatësisht të kompanisë “MAB” SH.P.K. Pas shqyrtimit edhe të shkresave të tjera të lëndës nuk është gjetur ndonjë kundërshtim apo mohim i bazuar nga ana e paditësit në lidhje

me atë se z. R.T nuk ka qenë punëtor i paditësit. Në këtë drejtim, Gjykata e shkallës së parë duke e bartur përgjegjësinë për ushtrimin e veprimtarisë së kundërligjshme minerare nga paditësi për tek z. A.B, në cilësinë e personit fizik, nuk ka shqyrtuar se çfarë lidhje mund të kishin pasur z. R.T. dhe z. A.B. Për këto arsye, Kolegji i kësaj gjykate faktin e nënshkrimit të urdhëresës në fjalë në emër dhe në llogari të paditësit nga ana e z. R.T. e vlerësoi si një fakt që paraqet një rrethanë tjetër të rëndësishme faktike që ishte dashur medoemos të merrej parasysh nga ana e Gjykatës së shkallës së parë për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike në lidhje me këtë çështje juridike administrative;

- 10.2. Sikurse edhe thënë më herët, Gjykata e shkallës së parë gjatë vlerësimit të Kontratës mbi Qiranë është përqendruar në përgjithësi, në qoftë se jo vetëm, në aspektin e pranueshmërisë dhe ekzistencës së Kontratës mbi Qiranë në aspektin formalo-juridik – ku sipas vlerësimit të Gjykatës së shkallës së parë në bazë të legjislacionit në fuqi për lidhjen dhe ekzistimin e një kontrate të qirasë përveç se nuk kërkohet noterizimi i të njëjtës, as forma e shkruar e saj. Megjithatë, Gjykata e shkallës së parë pas dhënies së këtyre vlerësimeve, sidomos duke pasur parasysh se kontratat e panoterizuara apo të paregjistruara, edhe pse mund të jenë të vlefshme si në shumë rrethana të qarkullimit juridik, për vërtetimin e ekzistencës dhe vlefshmërisë së tyre si rrjedhojë e mungesës së vërtetimeve noteriale apo të tjera duhet merren parasysh rrethana të tjera. Në këtë drejtim, Kolegji i kësaj gjykate vlerësoi se ekzistenca dhe vlefshmëria e këtyre kontratave të tilla, përkatësisht të panoterizuara apo të paregjistruara, paraqet një prezumim të rrzueshëm. Sipas vlerësimit të Kolegjit të kësaj gjykate, Gjykata e shkallës së parë nuk është përqendruar mjaftueshëm në shqyrtimin e ekzistencës dhe vlefshmërisë së Kontratës mbi Qiranë përtej aspektit formalo-juridik.
- 10.3. Për këtë çështje juridike administrative, Kolegji i kësaj gjykate sidomos mori në konsideratë pretendimin ankimor të të paditurit përmes të cilit i padituri ka theksuar se z. A..B edhe pse është paraqitur si person fizik plotësisht i shkëputur nga paditësi në cilësinë e kompanisë, i njëjti është vetë bashkëpronar i paditësit, përkatësisht i kompanisë “MAB” SH.P.K. Në këtë drejtim, Kolegji i kësaj gjykate gjeti se Gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë parasysh një rrethanë të tillë edhe pse në mesin e shkresave të lëndës janë gjetur disa kopje të certifikatave të biznesit të lëshuara nga ARBK për paditësin. Në shqyrtim e sipër të këtyre certifikatave të biznesit, Kolegji i kësaj gjykate gjeti se këto certifikata të biznesit edhe pse i takojnë paditësit, përkatësisht kompanisë “MAB” SH.P.K., të njëjtat janë lëshuar në kohëra të ndryshme. Kolegji i kësaj gjykate duke bërë analizimin e hollësishëm të të dhënave përmbajtësore në këto certifikata të biznesit gjeti se: në certifikatën e biznesit me të dhënë dalluese “31/05/2024, 08:58” dhe në certifikatën e biznesit me të dhënë dalluese “6/14/24, 9:10” pronarë/aksionarë të paditësit, përkatësisht të kompanisë “MAB” SH.P.K., rezulton të jenë z. M.B, me 85.00 % të kapitalit dhe z. A. B, me 15.00 % të kapitalit; ndërsa në certifikatën e biznesit me të dhënë dalluese “6/24/24, 10:11” pronar/aksionar i paditësit, përkatësisht i kompanisë “MAB” SH.P.K., rezulton të jetë z. M.B, me 85.00 % të kapitalit, përderisa për 15.00 % të kapitalit të mbetur është e pamundur, për arsye të paditura, të konstatohet se cili subjekt është pronar/aksionar. Pa paragjykuar mbi pranueshmërinë e këtyre certifikatave të biznesit si prova të besueshme në këtë konflikt administrativ, Kolegji i kësaj gjykate, duke pasur parasysh se nga dy certifikatat e para të biznesit z. A.B. paraqitet si pronar/aksionar i paditësit.

11. Gjykata ankimore, për pretendimet ankimore të të paditurit për zbatimin e gabuar të së drejtës materiale nga ana e Gjykatës së shkallës së parë, konstatoi se:
- 11.1. Konstatimi i gabuar apo jo i plotë i gjendjes faktike të kësaj çështje juridike administrative në konfliktin administrativ të zhvilluar nga Gjykata e shkallës së parë ka ndikuar në zbatimin e gabuar të së drejtës materiale nga ana e Gjykatës së shkallës së parë, edhe pse kjo e fundit normat juridiko-materiale përkatëse i ka interpretuar në mënyrë të saktë. Në këtë drejtim, sikurse edhe sqaruar më sipër, Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të saktë ka bërë interpretimin e dispozitave përkatëse të LMD-së përmes të cilit interpretim ka konstatuar se kontrata për qiranë, nga aspekti ligjor, nuk kërkohet që të ketë formën e shkruar dhe të jetë i noterizuar. Një konstatim i tillë i Gjykatës së shkallës së parë edhe pse paraqet një konstatim të saktë, Gjykata e shkallës së dytë vlerësoi se Gjykata e shkallës së parë në shqyrtim e sipër të ekzistencës dhe efektshmërisë së Kontratës mbi Qiranë në fjalë do të duhej të merrte parasysh edhe rrethanat e tjera faktike duke mos u kufizuar në interpretimin e bërë dispozitave përkatëse të LMD-së; dhe
- 11.2. Njësoj, një interpretim të saktë Gjykata e shkallës së parë e ka bërë edhe ndaj nenit 79, para. 4 të LMM-së. Mirëpo, Gjykata e shkallës së parë të njëjtën normë juridiko-materiale ishte dashur ta zbatojë vetëm pas shqyrtimit të plotë të fakteve dhe provave përmes së cilës do të bënte konstatimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike. Në këtë drejtim, duke u nisur edhe nga pretendimi ankimor i të paditurit, duhet theksuar se Gjykata e shkallës së parë gjatë zbatimit të së drejtës materiale në këtë çështje juridike administrative është kufizuar vetëm tek subjekti i cili në mënyrë direkte ka ushtruar veprimtarinë e kundërligjshme minerare dhe i cili është zënë në ushtrim të veprimtarisë së kundërligjshme. Kështu është anashkaluar neni 80, para. 1 i LMM-së që rrethin e personave përgjegjës në ushtrimin e veprimtarisë së kundërligjshme minerare e zgjeron edhe ndaj personave të tjerë që eventualisht kanë ndikuar tek të tjerët, qoftë përmes inkurajimit apo qoftë edhe përmes të ndonjë mënyre tjetër, në ushtrimin e veprimtarisë së kundërligjshme minerare.
- 11.2.1. Neni 79, para. 4 i LMM-së thekson: *“Nëse një person zhvillon aktivitete të hulumtimit, shfrytëzimit ose aktivitete të veçanta pa poseduar Licencën ose Lejen e nevojshme, KPMM do të nxjerrë urdhër përmes të cilit i shqipton këtij Personi një gjobë në shumën prej pesëmijë (5000) Euro për secilin aktivitet të këtillë”*.
- 11.2.2. Neni 80, para. 1 i LMM-së thekson: *“Çdo personi i cili angazhohet ose i cili inkurajon ose punëson persona tjerë për t’u angazhuar në aktivitete të shfrytëzimit ose hulumtimit të mineraleve pa posedimin e një Licence ose Leje nga KPMM, i shqiptohet gjoba administrative e përcaktuar në paragrafin 2. nën-paragrafi 2.1. të nenit 79 të këtij ligji dhe një masë burgimi deri në gjashtë (6) muaj”*.
12. Në formë të përmbledhur, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësuan se në këtë çështje juridike administrative nuk paraqet asses fakt kontestues se z. A.B ka ushtruar veprimtarinë e kundërligjshme minerare në parcelën tokësore të paditësit së bashku me mjetet e punës së paditësit. Mirëpo, fakt kontestues për Dhomat e Shkallës së Dytë ka dalur të jetë në qoftë se z.

A.B, këtë veprimtari të kundërligjshme minerare e ka ushtruar si person fizik fare pa pasur në çfarëdo mënyre lidhshmëri me paditësin, përkatësisht kompaninë “MAB” SH.P.K., apo në qoftë se ai këtë veprimtari të kundërligjshme minerare e ka ushtruar duke qenë pronar/aksionar i paditësit, përkatësisht i kompanisë “MAB” SH.P.K.

13. Prandaj, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësuan se Gjykata e shkallës së parë duke i pasur parasysh shkeljet e bëra me aktgjykimin e ankimuar, në rigjykim dhe rivendosje udhëzohet që së pari të shqyrtojë në qoftë se Kontrata mbi Qiranë e lidhur në mes të paditësit dhe z. A.B, e përjashton paditësen nga përgjegjësia për kundërvajtje, marrë parasysh faktin se z.A.B. si person fizik, paraqitet si pronarë i paditëses në certifikatën e biznesit. Me rastin e administrimit të provave gjykata e shkallës së parë të shqyrtojë se nga 3 certifikatat e biznesit të lëshuara nga ARBK për paditësin, përkatësisht për kompaninë “MAB” SH.P.K., të cilat gjenden në shkresat e lëndës, çfarë statusi kanë pasur personat e përfshirë në kompaninë paditëse në kohën e kundërvajtjes.
14. Nga sa u tha më lart, Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë gjeti se Gjykata e shkallës së parë në këtë çështje të konfliktit administrativ ka bërë shkelje të dispozitave procedurale të LPK-së, si rrjedhojë e të cilave shkelje procedurale, Gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, rrethanë kjo që pashmangshmërisht ka rezultuar edhe me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale. Prandaj, Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë në mbështetje të nenit 195, para. 1, pika (c) të LPK-së dhe në kuptim të nenit 198, para. 4 të LPK-së të ndërlidhur me nenin 63 të LKA-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
Dhomat e Shkallës së Dytë  
K.DH.SH.II.nr.1596/24 datë 24.12.2024

Kryetari i Kolegjit, gjyqtari  
Dren Rogova